

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE E QARKUT TIRANË
SHKOLLA 9 VJECARE GJOKAJ

Nr. 55 Prot

Tiranë, më 4.05.2015

NJOFTIM PËR KONKURIM PËR VEND TË LIRE PUNE

Shkolla "9 VJECARE GJOKAJ", Tiranë, në zbatim të Ligjit Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të Udhëzimit Nr.35, datë 30.09.2014 "Për procedurën e lëvizjes paralele, emërimit dhe të largimit nga puna të mësuesit në institucionin publik të arsimit parauniversitar", shpall njoftimin e kërkesave për konkurim, për vendin e lirë të punës në pozicionin **Mësues Gjuhe – Letersi** në :

1. Shkolla "Shkollën 9 vjecare Gjokaj", Tiranë. Të gjithë mësuesit e këtij profili (Gjuhe-Letersi), të interesuar për këtë pozicion pune (**Mësues Gj-L**), duhet të paraqesin pranë drejtorisë së Shkollës "9 vjecare Gjokaj", Tiranë, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Diplomë të ciklit të dytë të studimeve universitare, sipas përcaktimeve të nenit 57 të Ligjit Nr.69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë". (fotokopje e noterizuar e diplomës dhe listës së notave të shkollës së lartë).

b) CV dhe kopje të dëshmimeve apo dokumente që vërtetojnë pohimet në CV (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën Nr.1, bashkëlidhur Udhëzimit Nr.35, datë 30.09.2014).

c) Tabelën e të dhënave për aplikant (Sipas modelit të përcaktuar në shtojcën Nr. 2, bashkëlidhur Udhëzimit Nr.35, datë 30.09.2014).

d) Raportin mjeko - ligjor.

e) Dëshminë e masave disiplinore në fuqi në ngarkim të tij. (Nëse nuk ka e deklaron me shkrim që nuk ka).

f) Dëshminë e penaltetit, të lëshuar jo më herët se tre muaj para datës së aplikimit.

Dorëzimi i dokumentacionit të aplikimit për konkurim, do të bëhet pranë drejtorisë së Shkollës "9 vjecare Gjokaj", Tiranë, me adresë Rruga "Fshati Gjokaj", cdo ditë nga ora 08:00 – 14:00.

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të aplikimit për konkurim, do të jetë data 14.05.2015 ora 14.00.

Dokumentacioni për aplikim dorëzohet në drejtorinë e Shkollës "9 Vjecare Gjokaj". Tiranë, me procesverbal dorëzimi.

**DREJTOR
XHAVIT MUKA**

